REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr._____Prot. Maliq, më 21.08.2025

NJOFTIM

LËNDA: Mbi zhvillimin e mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak Maliq

DREJTUAR: KËSHILLIT BASHKIAK MALIQ
KRYETARIT TË BASHKISË MALIQ

Të nderuar,

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" datë 17.12.2015, i ndryshuar, neni 53, "*Funksionimi i këshillit bashkiak*", pika 4 dhe 5, neni 56 "*Kryetari i këshillit bashkiak*" pika 2 gërma "a", dhe në zbatim të Rregullores së Këshillit Bashkiak Maliq miratuar me vendim këshilli nr.24, datë 12.03.2020, "*Për miratimin e Rregullores së Këshillit të Bashkisë Maliq*" ju njoftojmë se mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak Maliq do të zhvillohet në sallën e mbledhjeve të këshillit ditën e **martë, më datë 26.08.2025**, **ora 10:00** me këtë,

Rend Dite:

1.Hapja e mbledhjes (korumi, miratimi i rendit të ditës, vendimet e mbledhjes së kaluar);
2.Deklarimi i konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimmarrjen lidhur me çështjet e rendit të ditës.
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 21.07.2025.
4. P-V "Për miratimin e Ndihmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin korrik 2025";
5.P-V "Për dhënie ndihme financiare për familje në nevojë";
6.P-V "Për miratimin e Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2025-2030";
7.P-V "Për dhënie ndihme financiare për familjen e znj.L.R banuese në fshatin Podgoire NJ.A Vreshtas dhe z.R.Z banues në Fshatin.Vloçisht Nj.A Libonik, banesat e të cilve u dogjën si shkak i rënies të zjarrit";
8. P-V"Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB-në nr.129, datë 26.12.2024, "*Për miratimin e numurit të punonjësve, nivelin e pagave të administratës së bashkisë Maliq dhe strukturave të tjera, për vitin 2025*";
9.P-V "Për një ndryshim në buxhetin e bashkisë Maliq viti 2025";
10.P-V "Për miratimin e marrveshjes për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta midis Njësive të Vetëqeverisjes Vendore dhe Këshillit të Ministrave të Republikës të Shqipërisë, për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore, akademia e trajnimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të Republikës të Shqipërisë (TALGA)";
11.P-V "Për miratimin e përditësimit të pjesshëm të listës së inventarit të pronave, të transferuara me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 524, datë 30.06.2010 "*Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Gorë, të Qarkut të Korçës*";
12.Diskutime të tjera.

Shënim: Mbledhjet e Komisioneve të Këshillit do të mbahen ditën e Hënë me datë 25.08.2025 nga ora 10:00-13:00 si më poshtë:

Komisioni i Mirëqënies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, Drejtave të Njeriut. Pikat 4, 5, 6 e rendit të ditës
z.Faslli Zholli, znj.Gentiana Drabo, z.Armando Dautllari, z.Plator Çollaku, znj.Marjeta Xhelollari

Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, dhe Planifikimit të Zhvillimit Strategjiktë Bashkisë, Mbikqyrjes Financiare. Pikat 8, 9, 10, 11 e rendit të ditës.
z.Petrit Kupe, znj.Pranvera Begolli, znj.Marianthi Avrami, znj.Eglantina Balli, z.Andonaq Risto.

Komisioni i Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Rehabilitimit. Pika 7 e rendit të ditës z.Dritan Çami, z.Ilia Xhuti, znj.Floreta Zaçe, z.Almir Elezi, z.Yllson Ibrahimllari

Ju faleminderit!

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI